

AKT THEMELIMI

DHE

STATUT

I

ARETE SHPK

Neni 1

Emërtimi

1.1 Emërtimi i shoqërisë është **ARETE SHPK** me poshtë e quajtur “Shoqëria”.

Neni 2

Personaliteti juridik

2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 3

Selia

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rr. Lagjja Mëzez, Autostrada Tiranë - Durrës, Km 5, Magazinë 1 Katëshe në Zonën Kadastrale 2679, Nr.Pasurisë 7/24, Vol.15, Faqe 186, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyrë dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyrë në vende të ndryshme, përveç selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 5

Objekti

5.1 Objekti i shoqërisë do të konsistojë në: Ne fushën e tregtisë import-eksport, me shumicë e pakice: të gjitha produkteve ushqimore, të produkteve, nënprodukteve blegtorale, bujqësore fruta-perime, të artikujve të ndryshëm industrial si veshmbathje, konfeksione, metrazhe, elektro-shtepiake, artikujve kozmetike, prodhim e tregtim të materialeve të ndërtimit, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, bimëve medicinale, të lendes drusore, plastike, duraluminit, bar-bufe, restorante, pike servisi, parking, lavazh, hotele, agjensi transporti etj.

5.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë



6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 10.000 lekë. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar nga ortakët sipas nenit 6.2 të këtij Akti Themelimi dhe përbëhet në tërësi nga kontribute në para.

6.2 Kapitali i Shoqërisë i Shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm **Z. Sofiel Beshi** e cila ka nënshkruar dhe zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej 10.000 lekë, që përfaqësojnë **100%** të kapitalit të Shoqërisë.

6.3 Kuotat janë të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe këtë Statut.

6.4 Përgjegjësia e ortakëve për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit

7.1 Zmadhimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 13 të këtij Statuti.

7.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë. Në çdo rast këto kontribute duhet të shoqërohen me një certifikatë për nënshkrimin e tyre ose një raport vlerësimi të kontributeve të kryer nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit

8.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me propozim të administratorit/ëve, vetëm në rastin kur Shoqëria mund të pësojë humbje të tilla që ta bëjnë të domosdoshëm këtë zvogëlim.

8.2 Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin e kapitalit sipas nenit 13 të këtij Statuti.

Neni 9

Transferimi i kuotave

9.1 Transferimi i kuotave ose pjesëve të tyre të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, trashëgimi, dhurim ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 10

Transferimi tek personat e tretë

10.1 Në rast transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, me shitje ose me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim, nëpërmjet një njoftimi drejtuar Administratorit. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat.

10.2 Në rast mosmarrëveshje midis palëve, vlera e kuotës që transferohet mund të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakord.

Neni 11

Asambleja e Përgjithshme

11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

11.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

11.3 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji në fuqi “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligje të tjera dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

11.4 Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

11.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të shoqërisë me të drejtë vote në Asamblesë të Përgjithshme.

11.6 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme e jashtëzakonshme.

Neni 12

Asambleja e Zakonshme

12.1 Asambleja e zakonshme mbledhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorëve, pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore.

12.2 Vendimet e zakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë, që përfaqësojnë të paktën 30% të kapitalit të Shoqërisë.

12.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 12.2, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite. Nëse edhe në mbledhjen e dytë nuk do të arrihet kuorumi i nevojshëm, ortakët e pranishëm përbëjnë kuorumin e kërkuar për marrjen e vendimit.

Neni 13

Asambleja e Jashtëzakonshme

13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të jashtëzakonshme sa herë është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.

13.2 Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, ndarjen e fitimeve, prishjen e Shoqërisë, konsiderohen vendime të jashtëzakonshme.

13.3 Vendimet e jashtëzakonshme merren nga ortakët me të drejtë vote, të pranishëm në mbledhjen e asamblesë, që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit të Shoqërisë.

13.4 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 13.3, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite. Në rast se në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.

Neni 14

Pjesëmarrja, Votimi dhe Përfaqësimi

14.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e një vote në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Vota e secilit prej ortakëve është e barabartë me vlerën e kontributeve të nënshkuara dhe shlyera dhe përlogaritet në proporcion me përqindjen e zotëruar dhe që përfaqëson në kapitalin e Shoqërisë.

14.2 Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 15

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

15.1 Asambleja e Përgjithshme vendos për:



- a. përcaktimin e politikave tregtare;
- b. ndryshimin e Statutit;
- c. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
- d. emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
- e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- h. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i. përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
- j. shpërndarjen e fitimeve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- m. çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.

Neni 16

Administratori/ët

16.1 Shoqëria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person fizik, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme. Në rast të administrimit të Shoqërisë nga dy administratorë, Shoqëria do të administrohet në mënyrë të përbashkët nga të dy administratorët sipas ligjit.

16.2 Administratori/ët emërohet/n për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi.

16.3 Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas ligjit.

16.4 Administratore e Shoqërisë është Z. Sofiel Beshi lindur në Vishocicë, Devoll, Shqipëri më 31.01.1993 e pajisur me kartë identiteti Nr. 035988116, me adresë në Rr. Mine Peza, Pallati 220, Sh.2, Ap.9, Tiranë.

Neni 17

Kompetencat e Administratorit/ëve


17.1 Administratori/ët është/janë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë dhe përfaqëson/jnë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët në përputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit të zbatueshëm.

17.2 Administratori/ët ka/në të gjitha kompetencat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme për administrimin e Shoqërisë, përveç atyre që sipas Statutit ose ligjit të zbatueshëm i takojnë Asamblesë së Përgjithshme.

17.3 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë ushtrimin e kompetencave të administratorëve, në rast se ka më shumë se një administrator, veç e veç ose së bashku.

17.3 Administratori/ët ka/në kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a. mbikëqyr dhe zbaton politikën e biznesit të Shoqërisë;
- b. përfaqëson Shoqërinë;
- c. kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standardet e mbajtjes së llogarive;
- d. përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e. siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaratim tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;



- f. siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të certifikuar dhe raporti i llogaritave publikë të certifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
- g. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- h. raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare;
- i. kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga ligji ose statuti.

Neni 18

Viti ushtrimor financiar

18.1 Viti ushtrimor financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor 2021.

Neni 19

Shpërndarja/likuidimi

19.1 Për shpërndarjen e Shoqërisë, në çdo kohë dhe për çdo arsye, si dhe për likuidimin dhe për emërimin e likuidatorëve, do të vendoset sipas dispozitave të ligjit shqiptar në fuqi.

Neni 21

Dispozita të përgjithshme

20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar të zbatueshëm në fushën e shoqërive tregtare.

20.2 Çdo konflikt që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Statuti, si dhe çdo konflikt që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, në rastet e përgjegjshmërisë, dhe raste të tjera, do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të gjykatave shqiptare.

20.3 Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose i tëri dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

22.4 Ky Statut është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar, sot më datë 09.03.2021, në Tiranë.

ORTAKU I VETËM - Z. SOFIEL BESHI

NENSHKRIMI

Sofiel Beshi

